



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO



Pranuar / Dorezuar Pomlono/Prodato Received/Delivroy		28.04.2022	2	viti god year
Organ /Mjesra Organ /Jednica Org./Out	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity	
SKIMETICK	2494/2022		113	



Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.344/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Jeton Koca-kryetar, Ardita Haxhnikaj-Demi dhe Arben Mehmeti-anëtarë, si dhe Sabile Avdyli-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.344/2022 të datës 07.04.2022 të parashtruar nga ankuesja me adresë banimi

kundër organit të punësimit Këshilli Gjyqësor i Kosovës, në çështjen juridike "kompensim material", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.8 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim me datë 28.04.2022, mori këtë:

V E N D I M

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, shpallet jo kompetent për të vendosur lidhur me ankesën A.nr.344/2022 të datës 07.04.2022 të parashtruar nga ankuesja

A r s y e t i m

Ankuesja ish e punësuar në Gjykatën Themelore në Prizren - dega në Dragash, me datë 07.04.2022 ka parashtruar ankesë me numër protokollit 1941/2022 të regjistruar me numër A.nr.344/2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit me numër 03-1392 të datës 20.08.2021 të Drejtorit të Përgjithshëm të Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, dhe Vendimit KA.nr.06/2022 të datës 25.02.2022 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, përmes të cilave vendime ankueses i është refuzuar kërkesa respektivisht ankesa për realizimin e tri pagave përcjellës me rastin e pensionimit, tri pagave jubilarë dhe kompensimi i shpenzimeve në emër të shujtës për ushqim.

Ankuesja pretendon se organet gjegjëse me rastin e nxjerrjes së vendimit për refuzimin e kërkesës gjegjësisht ankesës kanë bërë shkelje esenciale të dispozitave të Ligjit të Punës, Vërtetim jo të plotë dhe të gabuar të gjendjes faktike, dhe Zbatim të gabuar të drejtës materiale, sepse e njëjta pretendon se i plotëson të gjitha kushtet ligjore për kompensimin e



tri pagave përcjellës me rastin e pensionimit, tri pagave jubilarë, si dhe kompensimi i shpenzimeve në emër të shujtës për ushqim.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datën 13.04.2022 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesë të Sekretariati i Këshillit Gjyqësor të Kosovës, ndërsa me datë 20.04.2022 ka pranuar përgjigjen në ankesë nga organi i punësimit së bashku me provat e bashkangjitura të lëndës 1/16.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave administroi këto prova: Ankesën me numër protokollit 1941/2022 të regjistruar me numër A.nr.344/2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin me numër protokollit 03-1392 të datës 20.08.2021 të Drejtorit të Përgjithshëm të Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës; Vendimi DS-689/2021 të datës 20.12.2021 të nxjerrë nga Drejtori i Përgjithshëm i Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës; Vendimin KA.nr.06/2022 të datës 25.02.2022 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave në Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës; Ankesën me nr.01-331 të datës 07.02.2022 të parashtruar në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave; Kërkesën me nr.09-1785 të datës 04.11.2021 të parashtruar nga ankuesja në Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës; Kontratën e Punës për kohë të pacaktuar me nr.1.Gja nr.1/2017-116-48 të datës 14.06.2017.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës të parashtruara nga palët ka konstatuar se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës **nuk është kompetent** për të vendosur lidhur me ankesën e parashtruar nga ankuesja *SEPSE*:

Bazuar në shkresat e lëndës, gjegjësisht Kontratën e Punës me numër I.Gja.nr.1/2017-116-48 të datës 14.06.2017 të lëshuar nga Gjykata Themelore në Prizren, është vërtetuar se ankuesja *mban pozitën e punës Mirëmbajtëse Higjiene* në Gjykatën Themelore në Prizren – dega në Dragash.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, lidhur me verifikimin e kompetencës lëndore, ka analizuar dispozitat e Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, përkatësisht neni 4 paragrafi 4 ku përcaktohet se: *Personeli i punësuar nga institucionet e administratës në nivel qendror dhe komunal, përgjegjës për kryerjen e funksioneve mbështetëse dhe të mirëmbajtjes, nuk janë nëpunës civilë*, dhe rrjedhimisht ka konstatuar se parashtruesja e ankesës nuk e ka statusin e nëpunësit civil.

Në kuptim të kësaj dispozite ligjore, ministria përgjegjëse për administratë publike, me datë 08.12.2014 ka nxjerr Qarkoren Administrative, ndërsa Këshilli Gjyqësor i Kosovës me datë 16.05.2017 ka nxjerr Vendimin Nr.134/2017 ku përmes këtyre akteve juridike është përcaktuar se marrëdhënia e punës e kësaj kategorie të të punësuarve rregullohet me dispozitat e Ligjit të Punës. Rrjedhimisht ankuesja me datë 14.06.2017 ka nënshkruar Kontratën e Punës me numër I.Gja.nr.1/2017-116-48 për pozitën e punës *Mirëmbajtëse Higjiene* në Gjykatën Themelore në Prizren – dega në Dragash.

Andaj, duke u bazuar në nenin 6 paragrafi 1 nen paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ku përcaktohet se Këshilli



është kompetent për të shqyrtuar vetëm ankesat e nëpunësve civilë dhe kandidatëve për praninë në Shërbimin Civil si dhe duke marr parasysh konstatimin se ankuesja nuk e ka statusin e nëpunësit civil, Kolegji konstaton se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës nuk është kompetent për të vendosur lidhur me ankesën A.nr.344/2022 të datës 07.04.2022 të parashtruar nga ankuesja

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, duke marr parasysh se marrëdhënia e punës e ankueses ka qenë e rregulluar me dispozitat e Ligjit të Punës, udhëzon palën për ushtrimin e mjeteve juridike në pajtim me dispozitat e këtij ligji, përkatësisht nenin 79 ku përcaktohet se: *Çdo i punësuar i cili nuk është i kënaqur me vendimin me të cilin mendon se i janë shkelur të drejtat e tij, ose nuk merr përgjigje brenda afatit nga neni 78 paragrafi 2. të këtij ligji, në afatin vijues prej tridhjetë (30) ditësh, mund të inicioj kontest pune në Gjykatën Kompetente.*

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pas analizimit dhe vlerësimit të shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 6 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.8 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.344/2022

Sabile AVDYLLI

Procesmbajtëse



Vendimi i dërgohet:

- Ankueses
- Drejtorit të Përgjithshëm të Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës;
- Udhëheqësit të Personelit në Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së,